



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE



KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data
22.3.2021

Nr. Protokolli

2442

Lënda: Kërkesë për verifikim më të thelluar z. Rezeart Xhelal Tusha

DREJTUAR: PROKURORISË SË PËRGJITHSHME,

Adresa: Rruga "Qemal Stafa", nr.1, Tiranë

I nderuar z. Çela,

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin për funksionet publike si dhe përpunimin për formularin e vetëdeklarimit për kandidatët për Deputet në Kuvendin e Shqipërisë.

Referuar nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat, të cilit i takon të marrë mandatin e Deputetit, sipas ligjit nr. 10019, date 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar.

Z. Rezeart Xhelal Tusha, kandidat për deputet i Partisë Demokratike, qarku Durrës, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, formularin e vetëdeklarimit me nr. 2234 unik.

Në zbatim të nenit 15, pika 1, të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe Kreu VI, pika 6, Kreu V, pika 3, shkronja "b" e vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, verifikoi nëse ndonjë nga rrethanat e paraqitura nga z. Rezeart Xhelal Tusha, kandidat për deputet i subjektit politik Partia Demokratike, përfshihet brenda sferës së ndalimeve të parashikuara nga ligji.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të z. Rezeart Xhelal Tusha, rezulton se ka deklaruar:

- Në rubrikën III. "TË DHËNA MBI GJENDJEN GJYQËSORE TË PERSONIT", të Formularit të Vetëdeklarimit,

Pyetjes 7, “A është marrë për ju ndonjëherë masa e dëbimit nga një shtet i huaj?”, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “Po” duke deklaruar se:

Është marrë masë dëbimi në Zvicër për shkak të tejkalim të lejes së qëndrimit, në vitin 1994-1995, duke deklaruar se nuk disponon akt të dëbimit. Deklaron se e ndalojnë dhe i komunikojnë qqë i ka mbaruar leja e qëndrimit provizore dhe duhet të largohet nga Zvicra (komunikim verbal). Pas disa vitesh deklaroi se ka hyrë dhe herë të tjera në Zvicër pa asnjë problem.

Pyetjes 8, “A keni jetuar ndonjëherë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për më shumë se 1 muaj?”, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “Po” duke deklaruar se:

-Ka jetuar në Zvicër, për arsye emigracioni, për periudhën 1994-1995.

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e Integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” dhe Kreut V, pika 2, shkronja “b” dhe pika 3, shkronja “c” të Vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015”, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me shkresën nr. 2190 prot, datë 17.03.2021, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore, për kandidatin për Deputet, z. Rezeart Xhelal Tusha.

Në përgjigje të shkresës nr. 2850/1 prot, datë 17.03.2021 zyra e gjendjes gjyqësore, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatin për Deputet z. Rezeart Xhelal Tusha, qarku Durrës, sipas Vërtetimit të Gjendjes Gjyqësore rezultoi se z. Rezeart Xhelal Tusha nuk ka të dhëna në sistem.

Përsa i përket ndalimeve të parashikuara në nenin 2, pika 2, të ligjit nr.138/2015, për vepra penale të kryera jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, nuk ka kompetencën për të kryer verifikime.

Referuar indicieve të bëra publike nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë si dhe bazuar në nenin 8, pika 1, të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e Integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreu V, pika 2, shkronja “c”, të Vendimit të Kuvendit, nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, është Prokuroria e Përgjithshme, Drejtoria e Koordinimit Institucional, Sektori i Dekriminalizimit, që kryen verifikimin e plotë të deklarimeve të bëra, ndaj ju lutem vijoni në zbatim të ligjit.




Bashkëlidhur po ju dërgojmë:

- Kopje të njehësuar me origjinalin të formularit të vetëdeklarimit të z. Rezeart Xhelal Tusha.
- Shkresën nr. 2850/1 prot., datë 17.03.2021 të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve drejtuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI



Kopje: 3


Afati i mbylljes: 5 vjet

Punoi:

B. Kodra

M. Kojë

Y. Merkaç





KQZ
U PROTOKOLLUA!
NR 2190/PROT
DATE 17.3.2021
ora 19:30

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BURGJEVE
SEKTORI GJËNDJES GJYQËSORE

Nr. 2850/prot.

Tiranë, më 17.3.2021

Lënda: Kthim përgjigje suajës nr.2190, dt.17.03.2021.

KOMISIONIT QËNDROR TË ZGJEDHJEVE

TIRANË

Në përgjigje të suajës me nr.2190, dt.17.03.2021, mbas verifikimit në Regjistrin Elektronik të Gjëndjes Gjyqësore, me të dhënat e dërguara nga ana e juaj për shtetasit e propozuar për t'u zgjedhur deputet të Partisë Demokratike - AN, të listuar në shkresë sipas qarqeve (lista 1-9 Dibër, 1-45 Tiranë, 1-21 Durrës, 1-21 Elbasan, 1-18 Vlorë, 1-12 Berat, 1-21 Korçë, 1-9 Kukës, 1-24 Fier, 1-9 Gjirokastër, 1-21 Shkodër, 1-12 Lezhë) kërkohet vërtetimi i gjëndjes gjyqësore.

Nga verifikimi në këtë regjistër për 222 shtetas të listuar në kërkesë rezultoi se:

- për 1 shtetas (A.Brahimaj) ka të regjistruar dënime penale të formës së prerë;
- për 5 shtetas (Z.Hila, A.Dogjani, Xh.Mziu, E.Salianji) ka të regjistruar dënime penale të formës së prerë, rezultojnë të pushuar;
- për 1 shtetase (S.Daiu) ka të regjistruar dënime penale të formës së prerë, rezultojnë të rehabilituar në bazë të nenit 69 K.Penal.
- për 2 shtetas (E.Paloka, M.Nikollo) ka të regjistruar dënime penale të formës së prerë, rezultojnë të dënuar.

Ndërsa shtetasit e tjerë të listuar rezultojnë të padënuar.

Bashkëlidhur ju dërgojmë vërtetimin e gjëndjes gjyqësore për shtetasit e mëposhtëm:

1. Xhelal Mziu
2. Asllan Dogjani
3. Zef Hila
4. Ervin Salianji

Adresa : Rr. Zef Serembe, Tiranë

Tel: + 355 4 271437 Fax: + 355 4 22 82 92 website: www.dpbsh.gov.al e-mail: info@dpbsh.gov.al

5. Edi Paloka
6. Sonila Daiu

7. Armand Brahimaj
8. Manjola Nikollo

Mbyllet me nr.rendor 8 tetë.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM



Adresa : Rr. Zef Serembe, Tiranë
Tel: + 355 4 271437 Fax: + 355 4 22 82 92 website: www.dpbsh.gov.al e-mail: info@dpbsh.gov.al

PD-2234-DR



FORMULAR VETËDEKLARIMI

PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR. 138/2015 "PËR GARANTIMIN E INTEGRITETIT TË PERSONAVE QË ZGJIDHEN, EMËROHEN OSE USHTROJNË FUNKSIONE PUBLIKE"

DATE: 09/03/2021

I. TË DHËNAT PERSONALE


A. Gjeneralitetet aktuale

EMËR	REZEART
MBIEMËR	TUSHA
ATËSI	XHELAL
AMËSI	BAHRIE
DATËLINDJE	1.5.1972
VENDLINDJE	SHISAK
VENDBANIM	SHISAK
NR. ID	H2050 10 16P

B. Gjeneralitete të mëparshme

(Nëse keni ndryshuar zyrtarisht ndonjë nga të dhënat e gjeneralitetit tuaj, apo keni përdorur një gjeneralitet tjetër, qoftë edhe pa e ndryshuar zyrtarisht, listoni secilin prej tyre, duke plotësuar të gjitha të dhënat që janë ndryshuar dhe aq herë sa janë ndryshuar. Mosdeklarimi i ndonjë gjeneraliteti sipas kësaj pike, që mund të pengojë verifikimin sipas dispozitave të ligjit nr. 138/2015, përbën vepër penale sipas nenit 190 të Kodit Penal.)

EMËR	
MBIEMËR	
ATËSI	
AMËSI	
DATËLINDJE	
VENDLINDJE	


 (emër, mbiemër, nënshkrim)

II. MARRJE DIJENI MBI EFEKTET E FORMULARIT TË VETËDEKLARIMIT

Unë, i/e nënshkruari /a REZEART XHEHAL TUSHA, kam marrë dijeni dhe jam i vetëdijshëm se:

- a) Ky Formular përbën dokument zyrtar që i drejtohet një organi shtetëror dhe i nënshtrohet verifikimit dhe publikimit.
- b) Pasqyrimi i të dhënave të rreme në këtë Formular përbën veprë penale dhe dënohet me burgim sipas nenit 190 të Kodit Penal.
- c) Të dhënat e pasqyruara në këtë Formular i nënshtrohen verifikimit të plotë, brenda dhe jashtë Shqipërisë, nga organet shtetërore dhe Prokuroria e Përgjithshme.
- ç) Me plotësimin e këtij Formulari, kam dhënë pëlqimin për verifikimin e çdo të dhëne personale, përfshirë gjurmët daktiloskopike dhe çdo të dhënë tjetër biometrike.
- d) Pasqyrimi i të dhënave të pavërteta, të paplota, dhe të pasakta në këtë Formular dhe refuzimi i depozitimit të gjurmëve daktiloskopike, pasjell skualifikimin e menjëhershëm dhe në çdo kohë nga kandidimi/zgjedhja/emërimi apo ushtrimi i mëtejshëm i funksionit publik.
- e) Trajtimi i të dhënave do të kryhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Duke qenë i vetëdijshëm për pasojat ligjore në rast të deklarimeve të pavërteta, të paplota apo të pasakta, konfirmoj saktësinë e të dhënave të pasqyruara në këtë Formular.

KUJDES: JENI I/E SIGURT? SUGJEROHET QË NËNSHKRIMI I KËTJUI SEKSIONI TË BËHET PASI ËSHTË PLOTËSUAR SAKTË I GJITHË FORMULARIT

Rezeart Tusha
(emër, mbiemër, nënshkrim)

Rezeart Tusha
(emër, mbiemër, nënshkrim)

III. TË DHËNA MBI GJENDJEN GJYQËSORE TË PERSONIT

1. A jeni dënuar ndonjëherë me vendim gjyqësor të formës së prerë nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj? (Vendos X përbi përgjigjes)

PO JO

- Nëse po, specifikoni të dhënat e mëposhtme:

Të dhënat e vendimit gjyqësor				
Gjykata	Nr. dhe data e vendimit gjyqësor të formës së prerë	Masa e dënimit me burgim	Vepra penale për të cilën jeni dënuar	
			Neni	Lloji

2. A jeni dënuar me burgim me vendim gjyqësor jopërfundimtar nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj, për një çështje penale të pazqjidhur me vendim gjyqësor të formës së prerë? (Vendos X përbi përgjigjes)

PO JO

- Nëse po, specifikoni të dhënat e mëposhtme:

Të dhënat e vendimit gjyqësor				
Të dhënat e vendimit gjyqësor jopërfundimtar	Gjykata	Vepra penale për të cilën jeni dënuar		Vendimi përfundimtar/Dënimi
		Neni	Lloji	

Bezeard Tusha

(emër, mbiemër, nënshkrim)

3. A keni qenë ndonjëherë në hetim ose gjykim nga një autoritet i hual, për kryerjen e një vepre penale? (Vendos X përbri përgjigjes)

PO

JO

- Nëse po, specifikoni të dhënat e mëposhtme:

Organi procedues	Qyteti, Shteti	Arsyet	Periudha/Data	Rezultatet

4. A keni qenë ndonjëherë i ndaluar apo arrestuar nga organet ligjzbatuese, për kryerjen e një vepre penale? (Vendos X përbri përgjigjes)

PO

JO

- Nëse po, specifikoni të dhënat e mëposhtme:

Organi procedues	Qyteti, Shteti	Arsyet	Periudha/Data	Rezultatet

5. A është caktuar ndaj jush ndonjëherë masë shtrënguese e sigurisë personale, në fuqi ose jo? (Vendos X përbri përgjigjes)

PO

JO

- Nëse po, specifikoni të dhënat e mëposhtme:

Frederik Lusha (emër, mbiemër, nënshkrim)

MASAT SHTRËNGUESE TË SIGURISË **PËRGJIGJE**

	Aktualisht në fuqi	E revokuar
Ndalimi i daljes jashtë shtetit	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Ndalimi dhe detyrimi i qëndrimit në një vend të caktuar	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Garancia pasurore	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Arrestimi në shtëpi	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Arrestimi në burg	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Shtrimi i përkohshëm në një spital psikiatrik	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

- Nëse po, specifikoni të dhënat e mëposhtme:

Gjykata	Qyteti, shteti	Vepra penale për të cilën akuzoheshit		Vendimi përfundimtar	Periudha, data
		Neni	Lloji		

6. A është lëshuar ndonjëherë ndaj personit tuaj një urdhër kërkimi ndërkombëtar lidhur me kryerjen e veprave penale? (Vendos X përbri përgjigjes)

PO JO

Nëse po, specifikoni të dhënat e mëposhtme:

Autoriteti urdhërues	Arsyeja	Qyteti, Shteti	Ekzekutimi (nëse është në fuqi apo jo)

7. A është marrë ndonjëherë për ju masa e dëbimit nga një shtet i huaj? (Me përjashtim të rastit kur jeni dëbuar ekskluzivisht për shkeljen e rregullave të emigracionit që kanë të bëjnë me rregullat e qëndrimit apo hyrje-daljes në një territor të një shteti të huaj) (Vendos X përbri përgjigjes)

PO JO

Dezard Rugha
 (emër, mbiemër, nënshkrim)

- Nëse po, specifíkoni të dhënat e mëposhtme:

Qyteti dhe Shteti ku keni jetuar	Arsyeja dëblimit	Periudha e dëblimit nga shteti i huaj	Të dhanat e aktit të dëblimit
ZVICER	TESKALIM I LESES SË QENDRIMIT	AFERSISH 1984-85	NUK KAM DISPONUAR DHE NUK DISPONOZ
DIKU RRETH VITIT 1984-1985 MË NDAJOSHË DHE MË KOMUNIKONË QË MË KA MBARUAR LETA E QENDRIMIT PROVIZORË DHE DUHET TË LARGOHESHA NGA ZVICRA (KOMUNIKIMI ISHTË VERBAL) KAQ MË KUSTOHET NGA NGJARJA, DHE DUKË MOS POSEDUAR DOKUMENTACION POË KONSIDEROJ VETENTE DEBUAR. PAS DISA VITESH KAM HYRË NË ZUCERË DHE HERË TË TJERA			

- PA ASHKE 8. A keni jetuar ndonjëherë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për më shumë se 1 muaj? (Vendos X përbi përgjigjes)

PO JO

- Nëse po, specifíkoni të dhënat e mëposhtme:

Qyteti dhe Shteti ku keni jetuar	Arsyeja	Periudha	Adresa e vendqendrimit
ZVICER KANTON GRAUBUNDEN	EMIGRACION	1984-1985	KANTON GRAUBUNDEN

Duke qenë i vetëdijshëm për pasojat ligjore në rast të deklarimeve të pavërteta, të paplota apo të pasakta, konfirmoj saktësinë e të dhënave të pasqyruara në këtë Formular.

Bezeard Juska
(emër, mbiemër, nënshkrim)

Shënim: Në rast referimi të akteve, vendimeve dhe dokumenteve të caktuara, bashkëngjilini një kopje të tyre këtij Formulari.

Nëse pjesë të caktuara të Formularit janë të pamjaftueshme për deklarimin e të dhënave, shto atë pjesë sa ju nevojiten për pasqyrimin e të gjitha të dhënave.

Bezeard Juska
(emër, mbiemër, nënshkrim)